
KONTRATË

SHITJE KUOTASH

Sot më datë **10.12.2019**, bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të shoqërisë "**TECH - INSPECT**" SHPK, me Nr. NUIS L71607033D, si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

1. **Znj. Fjona ISUFI**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 10.02.1995, e identifikuar nga pasaporta me nr. BJ6803892 dhe me nr. personal J55210062A, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruese e një kuote/pjese të barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë "Tech - Inspect" SHPK, **nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"**.

dhe

2. **Z. Astrit ISUFI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25.05.1968, i identifikuar nga karta e identitetit nr. 034846989 dhe me nr. personal G80525227G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **nga këtu e më poshtë referuar si "BLERËSI"**.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të një kuote/pjese të barabartë me **50% (pesëdhjetë për qind)** të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë totale prej **ALL 500 (pesëqind lekë)**, që Shitësi zotëron në shoqërinë "TECH - INSPECT" SHPK me nr. NUIS L71607033D.

Neni 3

Çmimi i shitjes

Çmimi total i shitjes së kuotës/pjesës është ALL 500 (pesëqind lekë).

Neni 4

Mënyra e pagesës

Çmimi i shitjes së kuotës/pjesës i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej blerësit.

Neni 5

Detyrimet e shitësit

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotës, që ai kishte në shoqërinë "TECH - INSPECT" SHPK, kuotë/pjesë e cila tashmë i kalon Blerësit.

Shitësi garanton se kuota, e cila shitet me këtë kontratë, nuk është lënë peng, në dorëzani apo e rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i saj e gëzon të drejta të plota mbi të.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën/pjesën objekt i kësaj kontrate.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotës/pjesës që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 7

Hyrja në fuqi


Kjo kontratë hartohet në 2 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.


SHITËSI

Fjona ISUFI


FJONA ISUFI

BLERËSI

Astrit ISUFI


ASTRIT ISUFI